

UDHËZUES

ZHVILLIMI I NDËRMARRËSISË

Botuesi:
Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur

Përgatitur nga: Fikrije Zymberi

Për botuesin: Ragip Gjoshi
Redaktor gjuhësor: Berat Dakaj

Dizajni dhe përgatitja për shtyp: Jetmir Berisha
Gëzim Berisha

Përmbajtja

1.	Gjendja aktuale dhe arsyeshmëria	4
2.	Vlerësimi i situatës aktuale	5
2.1.	Kurrikula	6
2.2.	Cilësia e mësimdhënies	6
2.3.	Materialet për mësimdhënien e ndërmarrësisë	7
2.4.	Forma të tjera të promovimit të ndërmarrësisë	7
3.	Rekomandimet për Organizimin e Trajnimit për Trajnerë (TOT).....	9
3.1.	Të mësuarit e ndërmarrësisë.....	9
3.2.	Qëllimet dhe objektivat e TOT-it (Trajnimi i trajnerëve)	9
3.3.	Përmbajtja e trajnimit për trajnerë.....	10
3.4.	Organizimi i trajnimit për trajnerë	12
4.	Gara për Idenë më të Mirë të Biznesit në Shkollat Partnere të AAAPARr-s	13
4.1.	Arsyshmëria e organizimit të Garës për Planin e Biznesit më të Mirë	13
4.2.	Organizimi i Garës për Biznesplanin më të Mirë.....	13
	Shtojca 2: Shembulli i Testit të Ndërmarrësisë.....	14
	Shtojca 3: Agjenda Tentative e Trajnimit për Trajnerë I.....	16

Zhvillimi i Ndërmarrësisë në Shkollat e Mesme Profesionale, partnere të AAAPARr-s

Plani i veprimit

1. Gjendja aktuale dhe arsyeshmëria

Me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe për t'i arritur objektivat e rritjes së punësimit të vendeve në tranzicion siç është Kosova, konsiderohet i nevojshëm promovimi i ndërmarrësisë dhe mbështetja e ndërmarrësve. Roli i rëndësishëm i arsimit në promovimin e ndërmarrësisë tani është i njohur gjerësisht. Qëllimi i këtij raporti është t'i identifikojë mënyrat për promovimin e ndërmarrësisë në shkollat partnere të AAAPARr-s.

Me standardet rajonale Kosova është relativisht e varfër, me një GDP për kokë banori prej mbi 1 500 € në vit. Importet përbëjnë rreth 60 % të GDP-së dhe, deri tani, karakteristika kryesore që e përshkroi ekonominë e Kosovës është niveli shumë më i lartë i të hyrave sesa eksporteve nga burimet e tjera, kryesore janë dërgesat e dërguara nga diaspora dhe ndihma e donatorëve. Rritja ekonomike, e cila ka qenë e zhvendosur rreth 3 % e moderuar gjatë dy vjetëve të fundit, është drejtuar kryesisht nga procesi i privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe nga bizneset e vogla me pakicë. Investimet e huaja relativisht janë ende të ulëta, pjesërisht janë penguar nga mungesa e rregullt e energjisë elektrike. Papunësia - më shumë se 45 % e popullsisë është një problem i rëndë që nxit migrimin jashtë vendit.

Shkallë e lartë e papunësisë është e përhapur në Kosovë, veçanërisht në mesin e të rinjve. Programet e trajnimit që ndikojnë në nivelin e fuqisë punëtore të kualifikuar janë të rëndësishme për të hyrë në fuqi me anën e faktorëve të ofertës së fuqisë punëtore. Kjo është e rëndësishme sepse sistemi aktual i arsimit është duke bërë përpjekje për përmirësimin e ofertës së aftë të punës që në mënyrë adekuate t'u shërbejë nevojave të sektorit privat. Të dhënat tregojnë se programet edukative janë ende të pajisura keq për ta rritur punësimin e të diplomuarve, duke siguruar arsim të orientuar drejt praktikës së biznesit. Të diplomuarit e rinj nuk janë të përgatitur mirë për t'u qasur në tregun e punës në sektorin privat. Duke pasur parasysh se mungesa e shkathtësive themelore të biznesit është cituar si një pengesë e rëndësishme në zhvillimin e sektorit privat, ky ndikim është mjaft vendimtar. Për më tepër, procesi i privatizimit aktualisht është i dominuar nga kosovarët, zhvillimi i bizneseve lokale dhe krijimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në familje, kanë potencial për të kontribuar dukshëm në krijimin e vendeve të punës. Kjo ka qenë arsyeja e theksuar në disa raporte që kanë dhënë rekomandim strategjik që vëmendje t'i kushtohet krijimit dhe edukimit për ndërmarrësi në të gjitha nivelet. Arsimimi për ndërmarrësi në të gjitha nivelet është mjaft kritik në qoftë se kultura ndryshohet në drejtimin e njerëzve të cilët janë të gatshëm të marrin në konsideratë vetëpunësimin dhe ndërmarrësinë si një opsion të karrierës. Prandaj, zhvillimi i programeve për avancimin e shkathtësive të biznesit është thelbi i kësaj strategjie si tregohet edhe në kutinë më poshtë.

Kutia 1

Deficitet e aftësive praktike janë një ndër pengesat që dëmtojnë rritjen ekonomike të Kosovës dhe potencialin konkurrues. Ndër të tjera, ky raport potencon këto probleme:

- Investimet e ulëta nga ndërmarrjet për aftësimin e fuqisë punëtore
- Vështirësitë në oferta dhe marrja e trajnimeve të duhura për ndërmarrjet e vogla
- Rënie e përgjithshme në vlerat e vendosuara në arsimin e të riturve dhe
- Numri i madh i punëkërkuessve të pakualifikuar

Këtu nuk ka dyshim se mungesa e një programi gjithëpërfshirës në zhvillimin e aftësive në Kosovë e vë vendin në një disavantazh konkurrues dhe nëse mbetet pa u adresuar, do të vonojë edhe rritja e sektorit privat.

Strategjia e zhvillimit të sektorit privat në Kosovë, p. 33

Qëllimi i këtij raporti është për t'i adresuar sfidat kryesore dhe t'i ofrojë rekomandimet praktike në promovimin e edukimit të ndërmarrësisë në shkollat profesionale.

2. Vlerësimi i situatës aktuale

Kjo pjesë e raportit ofron një pasqyrë të situatës aktuale në arsimimin për ndërmarrësi në shkollat partnere të AAAPARr-s dhe në shkollat e tjera profesionale në Kosovë. Disa raporte kanë sugjeruar se edukim më shumë për ndërmarrësi nevojitet në të gjitha nivelet. Lënda e ndërmarrësisë është futur në tre vjetët e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë profesional. Megjithatë, këto shkolla nuk kanë arritur ende me sukses ta avancojë në masën e duhur edukimin për ndërmarrësi për disa arsye. Mungesa e materialeve dhe mungesa e aftësive praktike të mësimitdhënësve janë sfidat kryesore për këto shkolla. Gjithashtu, ndërmarrësia si një pjesë integrale e kurrikulës nuk është një përjashtim.

Tabela 1 ofron një pasqyrë të përparësive dhe të dobësive në lidhje me zhvillimin e ndërmarrësisë në shkollat partnere të AAAPARr-s dhe në shkollat e tjera profesionale.

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Moduli për ndërmarrësi është përfshirë zyrtarisht në kurrikulat e shkollave të mesme • Mandatet në dispozicion dhe funksionimi i mirë i firmave virtuale • Përkrahja e donatorëve ndërkombëtarë që kanë investuar në pajisjet për laboratorët dhe punëtoritë e shkollave) • Njohuri praktike të mësimdhënësve në profilet përkatëse • Standardet formale të kornizës së kualifikimeve dhe kurrikulave • Infrastruktura ekzistuese. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shumë nga mësimdhënësit nuk kanë ndonjë edukim paraprak shkollor për ndërmarrësi dhe mungesa e trajnimit për mësimdhënësit në ndërmarrësi • Mungesa e materialeve mësimore që çon në standarde jo të unifikuar të minimumit të outputit (të nxënit) • Nxënësit potencialë zgjedhin regjistrimin në shkollat profesionale jo si opsjon të parë • Nuk ka iniciativa të tjera për promovimin e ndërmarrësisë dhe kreativitetit (Konkursi, p.sh.: Organizimi i garës për idenë më të mirë në profilet përkatëse në kuadër të shkollave profesionale.

2.1. Kurrikula

Kurrikula ekzistuese ofron vetëm një modul që ndërlidhet me ndërmarrësi, i cili quhet Ekonomia dhe Ndërmarrësia. Ky modul ofrohet për tri vitet e shkollimit të mesëm të lartë dhe është menduar të ketë një ekuilibër mes temave të shtjelluara nga parimet e përgjithshme ekonomike (mikroekonomisë dhe makroekonomisë) dhe temave nga ndërmarrësia. Edhe pse në aspektin formal temave të shtjelluara nga ndërmarrësia u është dhënë një hapësirë e mjaftueshme në plan-programet mësimore, megjithatë ka pasur ngecje në arritjen e objektivave të zhvillimit të suksesshëm të edukimit për ndërmarrësi. Shkak për këtë janë dy arsye kryesore. Nga njëra anë mësimdhënësit nuk janë të trajnuar për mësimdhënie të ndërmarrësisë (shumica prej tyre), nga ana tjetër ka një mungesë të materialeve që do të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

2.2. Cilësia e mësimdhënies

Kuadri institucional i sistemit arsimor përbëhet nga tre elemente të një trekëndëshi: zhvillimi i kurrikulave, trajnimi i mësuesve dhe materialet mësimore. Sipas intervistave të zhvilluara me mësimdhënësit e shkollave partnere të AAAPARr-s, ka disa sfida që hasin mësimdhënësit. Para së gjithash, asnjëri prej tyre nuk kanë ndjekur ndonjë kurs specifik për ndërmarrësi në përgatitjen e tyre paraprake formale shkollore dhe universitare. Së dyti, ata nuk kanë mbajtur ndonjë kurs të projektuar enkas për

ndërmarrësinë dhe metodat bashkëkohore të ligjërimit të ndërmarrësisë që në një fare mënyre do t'i kompensonte mangësitë e mësimdhënësve në edukimin paraprak arsimor. Së fundi, ata nuk kanë material të veçantë për ndërmarrësinë dhe zakonisht ata duhet të bëjnë punë shtesë, në mënyrë individuale për ta kompensuar mungesën e librave, manualeve dhe materialeve të tjera mësimore.

2.3. Materialet për mësimdhënien e ndërmarrësisë

Mungesa ose pamjaftueshmëria e materialeve mësimore kanë qenë një nga pjesët më të vështira të mësimdhënies së ndërmarrësisë në arsimin e mesëm të lartë. Sipas intervistave me mësimdhënësit e shkollave partnere, është vënë në dukje se ata mbështeten në mësimdhënie sipas metodave të tyre të veçanta për mbledhjen e materialeve. Në bazë të rrethanave që mësimdhënësit nuk kanë përgatitje adekuate dhe trajnime specifike të lidhura me ndërmarrësi, mund të themi se këto shkolla nuk kanë të njëjtat standarde të mësimdhënies për ndërmarrësi në lidhje me rezultatet e mësimnxënies.

2.4. Forma të tjera të promovimit të ndërmarrësisë

Përveç zhvillimit të kurrikulës, mësimdhënies dhe materialeve për ndërmarrësi, bashkëpunimi dhe mbështetja e ndërmarrjeve në komunitetin lokal ku këto teza veprojnë, është pjesa jetike e strategjisë afatgjatë për rritjen e kapaciteteve ndërmarrëse në ekonominë lokale. Përmes sigurimit të edukimit për ndërmarrësi, vetëdija e madhe e nevojës për vlerën e të nxënësve mund të jetë e përlogaritur. Ky është hapi i parë për inkurajimin e brezit të ardhshëm të Kosovës dhe pronarëve të bizneseve të mundshme, dhe të punësuarit për të investuar në fitimin e aftësive dhe njohurive të nivelit të lartë dhe më tej në promovimin e një kulture të të nxënësve (OECD, 2009).

Në mënyrë që të promovohen shkollat profesionale të ndërmarrësisë duhet:

- Përcjellja dhe marrja e informacioneve lidhur me atë që se çka kanë arritur në karrierën e tyre nxënësit e këtyre shkollave. Nxënësit që kanë zgjedhur ndërmarrësinë dhe vetëpunësimin si opsion në karrierën e tyre mund të përdoren si ligjërues mysafirë në lëndën përaktëse të ndërmarrësisë dhe gjithashtu të shërbejnë si model për nxënësit
- Promovimi i mundësive ndërmarrëse për shkollat e mundshme. Këto do të ndihmojnë për regjistrimin e nxënësve më të mirë, e cila është një nga sfidat e shkollave profesionale
- Organizimi i praktikës për nxënësit. Kjo do të ketë dy efekte. E para, për t'i bërë shkollat profesionale më tërheqëse për regjistrimin e nxënësve më të mirë nga arsimi i mesëm në arsimin e mesëm të lartë. Së dyti, do të ndihmojë për t'i rritur aftësitë dhe shkathtësitë e punësimit për shkak se nxënësit do të jenë të familjarizuar me punën praktike të organizatës
- Vizita studimore në kompani (ndërmarrje). Disa memorandume të bashkëpunimit nënshkruhen me kompanitë për profilet përkatëse për vendosjen e nxënësve. Nëse nuk është e mundur për të gjithë nxënësit, mund të përdoren nxënësit më të mirë bazuar në punën e tyre në të mësuarit të cilët do të jetë nxitje për të mësuar më shumë për nxënësit e tjerë

- Integrimi i komponentit të ndërmarrësisë në shkollat virtuale. Bazuar në intervistat me përfaqësues të Swiss Contact-it dhe një koordinator të këtyre firmave virtuale është vërejtur se në këto firma ka infrastrukturë të mirë të biznesit dhe mbulim më të mirë të funksioneve të rëndësishme të menaxhimit dhe ndërmarrësisë, megjithëse nxënësit nuk janë mësuar në lidhje me shkathtësitë ndërmarrëse në mënyrë të qartë. Si pasojë, nxënësit praktikojnë përvojat e rëndësishme të fituara në punë sipas kontekstit të shoqërisë tregtare për përfundimin e detyrave në botën e vërtetë të biznesit, por ata nuk kanë fokus për edukimin dhe inkurajimin e nxënësve që të ushtrojnë funksione ndërmarrëse dhe kreative. Integrimi i komponentit për ndërmarrësi do t'i bëjë ata më kreativë
- Zhvillimi i një agjende të ndërmarrësisë në mënyrë të veçantë në kuadër të sistemit të arsimit në shkollat partnere të AAAPARr-s dhe shkollat profesionale në përgjithësi në mënyrë që të ketë një përqëndrim të fortë mbi rëndësinë e ndërmarrësisë si një opsion i karrierës. Menaxhmenti i shkollave profesionale duhet të bëjë përpjekje për promovimet e tilla si: prodhimin e broshurave me qëllim të nxitjes dhe promovimit të mundësive për nxënësit e këtyre shkollave. Në të njëjtën kohë masat e marra për ta përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe masat e tjera të sugjeruara në këtë raport të shkurtër vunë në dukje nevojën e promovimit me qëllim të tërheqjes së nxënësve të rinj
- Inkurajimi apo promovimi i shkathtësive kreative dhe inovative të nxënësve në të gjitha nivelet në arsimin e mesëm, të ulët dhe të lartë. Nga disa seminare me mësimdhënësit është vërejtur se mësimi nuk është orientuar drejt punës krijuese të nxënësve. Pjesëmarrësit duhet të marrin rolin e ndërmarrësisë dhe ta ushtrojnë dhe zhvillojnë kreativitetin e tyre duke i pyetur ata për krijimin e një biznesi.

3. Rekomandimet për Organizimin e Trajnimit për Trajnerë (TOT)

3.1. Të mësuarit e ndërmarrësisë

Standardet e mësimit për ndërmarrësi nuk kanë të bëjnë me një standard të vetëm profesional, por më tepër përfshijnë një shumëllojshmëri të shkathtësive profesionale. Nxënësit e angazhuar në mësime të ndërmarrësisë mund të pajisen me kompetenca të shumëllojshme në pajtim me fokusin e të mësuarit të tyre. Duhet të theksohet se të mësuarit e ndërmarrësisë përfshijnë dy elemente të ndryshme:

- Koncepte më të gjëra të të mësuarit të shkathtësive dhe qëndrimeve, e cila përfshijnë zhvillimin e cilësive të caktuara personale dhe nuk është e fokusuar drejtpërdrejt në krijimin e bizneseve të reja
- Koncepte më specifike të të mësuarit të mundësive ndërmarrëse, si të krijojnë, të drejtojnë dhe ta mbyllin/shesin një biznes.

Në veçanti, në nivelin e arsimit të mesëm profesional, zhvillimi i cilësive personale të përmendura më lart vazhdon të jetë relevant. Përveç kësaj, të mësuarit dhe ndërmarrësia përfshijnë:

- Ngritja e vetëdijes të nxënësve për vetëpunësim si një opsion i mundshëm i karrierës (me informimin e nxënësve që ata mund të bëhen jo vetëm punëtorë, por edhe ndërmarrës). Kjo është e rëndësishme për tërheqjen e nxënësve të rinj
- Learning by doing - të mësuarit duke i bërë gjërat, duke drejtuar ndërmarrje të vogla (p.sh., stimulimi i firmave praktike, i firmave trajnuese, apo firmave virtuale që tashmë janë duke funksionuar)
- Trajnime specifike se si të krijojmë (dhe të drejtojmë) një biznes (sidomos në shkollat profesionale ose teknike).

3.2. Qëllimet dhe objektivat e TOT-it (Trajnimi i trajnerëve)

Komponentët e trajnimit për trajnerë duhet të përfshijnë një seri të punëtorëve me mësues të shkollave partnere të AAAPARr-s dhe shkollave të tjera profesionale. Në këtë plan të veprimit ne propozojmë të paktën tri punëtorë, që do të përfshijnë tema të ndryshme që janë pjesë e kurrikulës për lëndën Ekonomia dhe Ndërmarrësia (agjenda paraprake është dhënë në Shtojcën 3). Rreth 12 mësues nga katër shkollat partnere të AAAPARr-s pritet të marrin pjesë në këto trajnime. Një ekspert në fushën e ndërmarrësisë duhet ta mbajë trajnimin dhe të jetë përgjegjës për trajnimin. Trajnimi do të bazohet në materiale të përgatitura nga AAAPARr-ja.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij seminari do të jetë, për të forcuar më tej të mësuarit e ndërmarrësisë të bazuar në kurrikulën aktuale dhe ngritjen e kapacitetit të të nxënësve në

fushën e ndërmarrësisë, në institucionet e arsimit profesional. Në arritjen e këtij qëllimi, seminari synon ta forcojë bashkëpunimin ndërmjet shkollave partnere të AAAPARr-s dhe të shkollave të tjera profesionale, ndarjen e njohurive dhe përvojave, shkëmbimin e praktikave më të mira në të dy fushat, mësimnxënien dhe mësimdhënien e ndërmarrësisë. Qëllimi kryesor i punëtorisë është t'i zgjerojë dhe t'i forcojë njohuritë e mësimdhënësve për ligjërimin e lëndës së ndërmarrësisë në shkollat përkatëse, duke nxitur frymën ndërmarrëse dhe kreativitetin e nxënësve të këtyre shkollave.

Përveç kësaj, kontributi i punëtorive do të jetë i dyfishtë. Së pari, shkollat do të bëhen më tërheqëse për nxënësit potencialë për regjistrim në këto shkolla duke tërhequr nxënësit më të mirë përmes promovimit të ndërmarrësisë në profilet përkatëse si një opsion i mundshëm i zgjedhjes së tyre në karrierë. Së dyti, do të ndihmohet në krijimin e standardeve të mësimdhënies në lëndën që ka të bëjë me ndërmarrësinë në shkollat përkatëse, duke adaptuar materialet e njëjta dhe metodat e mësimdhënies e cila do të çojë në standardizimin dhe unifikimin e rezultateve të mësimin. Punëtoritë do të kenë këto objektiva specifike:

- Rritja e të kuptuarit të ndërmarrësisë, nga ana e literaturës moderne mbi principet e ndërmarrësisë
- Aftësimi i mësimdhënësve me njohuri për zbatimin e metodologjisë moderne dhe teknikave për mësimdhënien e ndërmarrësisë.

3.3. Përmbajtja e trajnimit për trajnerë

Trajnimi/punëtoritë do të përfshijnë të gjitha vitet e arsimit në shkollimin e mesëm të lartë. Bazuar në kurrikulën ekzistuese, duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme zgjedhja e temave për diskutim në mënyrë që t'i zgjerojë njohuritë në mësimdhënien e temave të ndërmarrësisë ndërmjet pjesëmarrësve/mësimdhënësve. Të gjitha temat e trajtuara në seminar do të zhvillohen në frymën e ndërmarrësisë ndërmjet pjesëmarrësve duke i vendosur ata në pozitë të ndërmarrësit (shih Shtojcën 3 për detaje).

Temat e mundshme për përfshirje në trajnim për trajnerët përmbajnë:

- Aftësitë ndërmarrëse
- Kreativiteti dhe inovacioni
- Aftësitë menaxheriale dhe udhëheqja
- Hulumtim dhe marketing
- Zhvillimi i bizneseve të reja
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe organizimi
- Menaxhimi i financave, kontabiliteti dhe ligjet
- Menaxhimi i projektit
- Komunikimi dhe aftësitë komerciale
- Zhvillimi i planit të biznesit

Përveç këtyre temave, gjatë gjithë “workshop”-it vëmendje e veçantë do t'i kushtohet metodologjisë së mësimdhënies të zbatuar nga institucionet arsimore, të ngjashme në vendet perëndimore. Do të përdoren në mënyrë intensive teknika të tilla si

raste studimore, lojëra të biznesit, vizita në kompani, mysafirë ligjërues, punë ekipore. Gjithashtu, si mjet për stimulimin e konkurrencës do të zbatohet shpërblimi në këto trajnime dhe mësuesit do të inkurajohen fuqishëm të aplikojnë këto teknika në mësimdhënie. Këto metodologji moderne të mësimdhënies në ndërmarrësi priten t'i rrisin kapacitetet e mësimdhënies në ndërmarrësi apo edhe ta shtojnë kreativitetin në mësimdhënie në shkollat përkatëse. Të gjitha metodat e cekura më lart do të përdoren nga pjesëmarrësit gjatë të mësuarit në trajnim. Pjesëmarrësit do ta kenë rolin e nxënësve dhe nga ata do të kërkohet për të kryer çdo teknikë derisa ata të familjarizohen me aplikimin praktik të teknikave të veçanta dhe materialeve të ngjashme. Kjo do t'u mundësojë atyre të jenë në gjendje për të përfunduar të njëjtin ushtrim me nxënësit e tyre në shkollat e tyre.

Përveç kësaj, për të mësuar ndërmarrësinë në mënyrë efektive, mësimdhënësi duhet t'i përdorë disa nga atributet e njëjta që ai ose ajo do të përpiqet që të adaptojë për aplikim nga nxënësit. Me fjalë të tjera, mësimdhënësi duhet ta praktikojë të mësuarit e ndërmarrësisë. Të bëhesh një mësimdhënës me iniciativë duhet t'i përdorësh aftësitë kyçe ndërmarrëse dhe atributet ku në këtë mënyrë do të shërbesh si model ndërmarrës dhe këshilltar për nxënësit. Për këtë arsye, ne sugjerojmë që mësimdhënësit duhet të përfshihen në aplikimin praktik të aftësitë ndërmarrëse në praktikë gjatë trajnimit.

Pjesëmarrësit/mësimdhënësit do të inkurajohen që të iniciojnë dhe të kërkojnë mbështetjen e menaxhmentit të shkollave për t'i shikuar mundësitë për partneritet me partnerët e jashtëm, siç është, komuniteti i biznesit. Kjo, ndër të tjera, përfshin memorandumimin e bashkëpunimit, nënshkruar me disa kompani të cilat do të jenë në gjendje për t'i vendosur nxënësit (të paktën një grup të vogël të tyre) në kompani të ndryshme për të fituar përvojë praktike.

Përmbajtja e punëtorive do të përfshijë materiale dhe teknika të ngjashme në ndërtimin e kompetencave të ndërmarrësisë si në vijim:

- *Kompetencë ndërmarrëse.* Shkathtësitë teknike, njohuritë dhe të kuptuarit në ngritjen e një biznesi/ndërmarrje, si dhe aftësitë personale dhe qëndrimet që përcaktojnë një ndërmarrës; zgjerimi i aftësive ndërmarrëse
- *Kompetencë profesionale.* Shkathtësitë kryesore, njohuritë dhe të kuptuarit si zgjidhja e problemeve, duke punuar me të tjerët, por edhe aftësitë, njohuritë dhe të kuptuarit që kanë të bëjnë me profesione të ndryshme (p.sh. financimi me pakicë ose çështjet e administratës)
- *Komunikimi dhe kompetenca sociale.* Aftësitë kryesore, njohuritë dhe të kuptuarit në komunikim efektiv dhe aktiviteteteve ndërpersonale, sikurse edhe shqetësimet etike, morale, kulturore
- *Kompetencë personale.* Zhvillimi i autonomisë, përgjegjësisë, rolit personal, performanca vetjake dhe të nxënësve.

Për të përfunduar, mësimi i ndërmarrësisë, veçanërisht në arsimin e mesëm të lartë, është formues në natyrë. Ai synon ta nxisë zhvillimin e karakteristikave, qëndrimeve dhe aftësive që janë të rëndësishme për iniciativë ndërmarrëse. Prandaj, edhe pse shumë edukatorë nuk mund të kenë përvoja të biznesit, shumica janë të kualifikuar në procedurat për të ndërtuar dhe ndikimin e tyre në formimin e qëndrimeve të nxënësve në klasë.

3.4. Organizimi i trajnimit për trajnerë

Eksperti i përzgjedhur nga AAAPARr-ja do t'i drejtojë punëtoritë. Ai duhet ta përgatisë përmbajtjen e hollësishme të punëtorisë dhe agjendën (një agjendë paraprake është dhënë në Shtojcën 3). Mbështetje teknike dhe logjistike duhet të ofrohet nga personeli i AAAPARr-s. Përgatitjet përfshijnë planifikimin dhe përcaktimin e përmbajtjes dhe agjendën e seancave të trajnimit, përdorimin e formave dhe materialeve të tjera (formën e 'feedback'-ut, formatin e reklamave të seminareve për planet konkrete vepruese) dhe prezantime për ndërmarrësinë.

Trajnimi i trajnerëve duhet të përfshijë katër seri të punëtorive. Kjo është konsideruar të jetë e mjaftueshme në mënyrë që të përfshijnë fusha të listuara në seksionin e mëparshëm.

4. Gara për Idenë më të Mirë të Biznesit në Shkollat Partnere të AAAPARr-s

Analiza SWOT tregon se format e tjera për promovimin e ndërmarrësisë në shkolla nuk janë zhvilluar. Organizimi i konkurseve të biznesit është përdorur gjerësisht në mënyrë që ta promovojë frymën ndërmarrëse ndërmjet të rinjve. Kjo mund të veprojë si një mjet për promovimin e vetëpunësimit dhe të ndihmojë në ndërtimin e kreativitetit tek të rinjtë. Pakoja mbështetëse (Çmimi i përfituesit) të këtyre garave mund të shkojë nga disa euro e deri tek mbështetja e përfituesve në krijimin e kontakteve me disa investitorëve të mëdhenj të cilët janë gati për ta çuar idenë në nivelin e ardhshëm të zhvillimit.

4.1. Arsyshmëria e organizimit të Garës për Planin e Biznesit më të Mirë

Organizimi i konkursit të planit të biznesit për idenë e biznesit më të mirë në profilet përkatëse të shkollave partnere të AAAPARr-s do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrësisë.

Kjo ngjarje do të ketë një ndikim të madh në disa aspekte:

- Nxitja e kulturës ndërmarrëse dhe kreativitetit tek nxënësit
- Do të ndihmojë në promovimin e reputacionit më të mirë të shkollave dhe nxënësve në lidhje me aktivitetet joklasore
- Vepron si një nxitje jo vetëm për regjistrimin, tërheqjen e nxënësve, por do të veprojë si një nxitje për të mësuar më shumë për ndërmarrësinë në modulën e tyre formal
- Mundësia që planbizneset fituese me burime të ndryshme mund të financohen nga burimet e tjera, (donatorët, bankat dhe investitorë potencialë). Edhe në qoftë se plani nuk do të fitojë, ata do të kenë “feedback” nga investitorët e vërtetë në qëndrueshmërinë e planit të biznesit
- Mundësia e gjenerimit të punësimit për vetë nxënësit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

4.2. Organizimi i Garës për Biznesplanin më të Mirë

Shtojca 1: Rëndësia e Integritit të Ndërmarrësisë në Edukimin e Mesëm

Organizimi i Garës për Biznesplanin më të Mirë për shkollat partnere duhet të jetë në formën e konkursit për idenë e biznesit më të mirë. Plani i biznesit konkurrues përbëhet nga katër hapa.

- Aplikimi për idenë më të mirë konkurruese Në këtë fazë formulari i thjeshtë do të përgatitet për nevojat specifike dhe që i përgjigjet nivelit të mesëm të lartë shkollor. Organizimi mund të inkurajojë që idetë e biznesit të drejtë mund të jenë edhe të bazuara në familje apo biznes (p.sh., duke përfshirë edhe disa anëtarë të familjes në biznesin e familjes), por të paktën njëri prej tyre duhet të jetë i regjistruar në shkollat partnere të AAAPARr-s

- Zgjedhja e idesë më të mirë të biznesit. Juria e pavarur duhet të organizohet në mënyrë që të ketë konkurrencë të drejtë ndërmjet të rinjve. Juria duhet të përbëhet nga katër persona: një përfaqësues të mësuesve, një përfaqësues të AAAPARr-s, një konsulent i pavarur/ekspert dhe përfaqësues të mundshëm të organizimit të donatorëve që mund të sigurojnë fonde për planin e biznesit më të mirë
- Shpërblimi i fituesve të planit të biznesit. Më pas mund të ofrohen stimuj për ta inkurajuar zgjerimin e pjesëmarrjes së nxënësve
 - Donatorët mund të ofrojnë sasi të vogël parash për tre vendet e para, si stimulim për nxënësit
 - Organizimi i trajnimeve specifike ose konsulencë për fituesit
 - Ndërlidhje në mes të idesë më të mirë të biznesit me donatorët e mundshëm dhe investitorëve, për t'i ndihmuar ata në krijimin e firmave të vogla. Në këtë drejtim, marrëveshjet e bashkëpunimit mund të nënshkruhen me donatorë të ndryshëm
 - Organizimi i ceremonisë/ngjarja përmbyllëse për të gjithë nxënësit dhe aplikantët fitues do të shpallet zyrtarisht
 - Promovimi i ngjarjes dhe fituesve në mediet lokale.

Shtojca 2: Shembulli i Testit të Ndërmarrësisë

TEST I NDËRMARRËSISË - A duhet të jeni ndërmarrës?

Studimet e ndërmarrësve të suksesshëm zbulojnë karakteristikat e përbashkëta, prejardhjen e familjes, përvojën, motivimet, tiparet e personalitetit, sjelljet, vlerat dhe besimin. Si mund të përshtaten këto modele? Çfarë është E. Q. juaj (koeficienti i ndërmarrësisë)? Northwestern Mutual Life ka krijuar testin e mëposhtëm për të parashikuar se sa të përshtatshëm jeni ju ndaj ndërmarrësisë. Ky test nuk mund ta parashikojë suksesin tuaj - mund t'ju japë vetëm një ide nëse ju do të keni një pikënisje apo kufizim me të cilin do të punoni. Aftësia për ndërmarrësi mund të mësohet. Testi është menduar që t'ju ndihmojë të shikoni se si ju krahasoheni me ndërmarrës të suksesshëm.

Shtoni ose hiqni rezultatin tuaj ashtu si ju e vlerësoni veten:

- Ndërmarrës të suksesshëm nuk janë, si rregull, të dalluar në shkollë. Nëse keni qenë një student ndër më të mirët, hiqni katër. Nëse jo, shtoni katër
- Ndërmarrësit nuk janë veçanërisht entuziastë për të marrë pjesë në aktivitetet e grupit në shkollë. Nëse ju kanë gëzuar aktivitetet e klubeve, ekipeve sportive, zbritni një. Nëse jo, shtoni një të tillë
- Studimet e ndërmarrësve tregojnë se, si të rinjtë preferojnë të shumtën e kohës të rrinë vetëm. A preferoni ju të rriini vetëm si një i ri? Nëse është kështu, shtoni një të tillë. Nëse jo, hiqni një të tillë
- Ata që filluan të merren me ndërmarrësi që nga rinia si, p.sh., me shitjen e limonadës në stenda, gazeta familjare, me shitjen e kartolinave, ose kanë qenë anëtarë të kryesisë së shkollës, mund të shtojë dy, sepse ndërmarrësia zakonisht

mund të gjurmohet në një moshë të re. Nëse ju nuk e keni iniciuar ndërmarrësin, zbrisni dy

- Kokëfortësia në rini, duket se të përkthehet në vendosmërinë për të bërë vetë gjërat në mënyrë personale. Nëse keni qenë kokëfortë si një fëmijë, shtoni një të tillë. Nëse jo, hiqni një të tillë
- Kujdesi i tepërt mund të përfshijë një mosdëshirë për të marrë rreziqe, një kufizim për ata që hyjnë në territorin e paeksploruar më parë. A ishit ju një djalë i kujdesshëm? Nëse po, zbrisni katër. Nëse jo, shtoni katër
- Nëse keni qenë një nga ata që rrezikojnë, shtoni katër më shumë
- Ndërmarrësit shpesh kanë besim të ndjekin një rrugë, pavarësisht nga mendimet e të tjerëve. Në qoftë se mendimet e të tjerëve ndikojnë në ju, hiqni një të tillë. Nëse jo, shtoni një të tillë
- Duke qenë të lodhur nga një rutinë e përditshme, shpesh mendojmë vendimin e një ndërmarrësi për të nisur një ndërmarrje. Në qoftë se për ju ndryshimi i rutinave të përditshme do të jetë një motivim i rëndësishëm për fillimin e ndërmarrjes tuaj, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- Po ju me të vërtetë kënaqeni me punën? Por a jeni të gatshëm të punoni edhe gjatë natës? Nëse po, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- Nëse jeni të gatshëm për të punuar punë që si kohë merr më pak ose aspak gjumë për të mbaruar një punë, shtoni katër më shumë
- Ndërmarrësit përgjithësisht janë të kënaqur me profilet e punëve dhe lëvizin nga një projekt në tjetrin vazhdimisht. Kur të keni përfunduar një projekt me sukses, ju menjëherë filloni një tjetër? Nëse po, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- Ndërmarrësit e suksesshëm janë të gatshëm t'i përdorin kursimet e tyre për të financuar një projekt. Nëse jeni të gatshëm të angazhoheni në kursimet tuaja për të filluar një biznes, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- A do të jeni të gatshëm për të marrë hua nga të tjerët? Nëse po shtoni dy më shumë. Nëse jo, zbritni dy
- Në qoftë se biznesi juaj dështon, do të filloni menjëherë të punoni në një tjetër punë? Nëse po, shtoni katër. Nëse jo, zbrisni katër
- Ose ju do të filloni menjëherë të kërkoni një punë me një pagë të rregullt, hiqni një më shumë
- A besoni se duke qenë një ndërmarrës është e rrezikshme? Nëse po, zbritni dy. Nëse jo, shtoni dy
- Shumë ndërmarrës paraqesin qëllimet e tyre afatgjata dhe afatshkurtra me shkrim. Nëse e bëni këtë, shtoni një të tillë. Nëse ju nuk e bëni, hiqni një të tillë
- Trajtimi i rrjedhës së parasë mund të jetë kritik për suksesin e sipërmarrjes. A besoni se ju keni mundësinë të merreni me rrjedhjen e parave në mënyrë profesionale? Nëse është kështu, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- Personaliteti i ndërmarrësit shumë lehtë mund të kalojë në monotoni. Nëse mërziteni lehtë, shtoni dy. Nëse jo, zbritni dy
- Optimizmi mund t'i shuajë apetitet e juaja drejt suksesit. Nëse ju jeni një optimist, shtoni dy. Pesimist, zbritni dy.

Çfarë është K. N. juaji (Koeficienti i Ndërmarrësit)?

Nëse ju arrini + 35 pikë apo më shumë, ju keni çdo gjë që ju përshtatet. Ju keni aftësi të arrini sukses spektakular si ndërmarrës (përfshirimi i akteve të Zotit ose variablave të tjera jashtë kontrollit tuaj).

Në qoftë se ju arrini + 15 deri + 34 pikë. Prapavija, aftësitë dhe talentet ju japin mundësi të shkëlqyer për sukses në biznesin tuaj. Ju duhet të shkoni larg.

Nëse keni arritur prej 0 deri në + 15 pikë, ju keni aftësi ose përvojë për ta udhëhequr një biznes dhe do të duhej të jeni të suksesshëm në hapjen e një ndërmarrje nëse i mësoni aftësitë e nevojshme.

Nëse keni arritur 0 deri në - 15 pikë ndoshta do të keni suksese nëse e filloni këtë punë vetë, por do t'ju duhet të punoni shumë për ta kompensuar mungesën e avantazheve të aftësive që i kanë të tjerët në fillimin e biznesit.

Nëse keni arritur - 15 deri në - 43, ju keni talent për diçka tjetër. Ju duhet të rishqyrtoni nëse fillimi i një biznesi është ajo çfarë ju doni, pasi mund të notoni në kuadër të valëve shumë të mëdha. Ndonjë tjetër angazhim pune, puna në ndonjë kompani të huaj ose zhvillimi i një profesioni në një fushë teknike, do të ishte një mundësi më e mirë për ju dhe do t'ju ofronte një stil jetese më të përshtatshëm për ju.

Shtojca 3: Agjenda Tentative e Trajnimit për Trajnerë I

Emri i punëtorisë: Trajnimi i trajnerëve, punëtorja mbi ndërmarrësinë 1

Trajneri i punëtorisë: Emri:
Titulli i pozitës:
Kompania:
Adresa elektronike:

Kohëzgjatja e punëtorisë: 2 ditë

Qëllimet, objektivat dhe të arriturat e mësimi:

Kjo punëtori ka katër qëllime:

- (a) T'u japë pjesëmarrësve informata bazike mbi ndërmarrësinë
- (b) Që t'i mësojë pjesëmarrësit se si të gjenerojnë dhe të zgjedhin ide më të mira të biznesit
- (c) Që t'i mësojë pjesëmarrësit se si t'i strukturojnë synimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata
- (d) Që t'u japë pjesëmarrësve informata bazike mbi ndikimin e ambientit në biznese.

Objektivat kryesore janë:

- a) Të vejtëdijësohen pjesëmarrësit mbi atë se çfarë do të thotë të jesh një ndërmarrës
- b) Cilat janë karakteristikat e një ndërmarrësi
- c) Identifikimi i karakteristikave personale të një ndërmarrësi

- d) Sfidat, avantazhet dhe disavantazhet e ndërmarrësisë.
- e) Vetëdijesimi i pjesëmarrësve mbi rëndësinë e vendosjes së një plani të qëllimeve.
- f) Që të mësojnë pjesëmarrësit se si t'i gjenerojnë idetë e biznesit dhe si t'i përzgjedhin idetë më të mira.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Dituria e mësimdhënësit, të kuptuarit dhe aftësitë e ndërmarrësisë do të facilitohen përmes ligjëratave formale, diskutimeve, punës grupore dhe zhvillimit të projektplaneve sipas planprogramit tabelor por, gjithashtu, edhe përmes studimeve individuale dhe përgatitjes për detyrat individuale dhe atyre në grup.

Seancat tabelore në përgjithësi do të realizohen përmes ligjëratave interaktive dhe përvojave të integruara, sikurse janë: diskutimet kritike, ushtrimet, shembujt, videot, studimet specifike etj. Në mënyrë që të rritet kuptimi i ndërmarrësisë dhe që t'u ndihmojë t'i aplikoni idetë e kuptuara.

Prandaj, çelësi është të jeni pjesëmarrës me diskutimin dhe komentet e juaja gjatë trajnimit. Rekomandohet që t'i ndani idetë, pikëpamjet dhe opinionet e juaja me pjesëmarrësit e tjerë dhe të ndani me ta përvojat e juaja specifike. Diskutimet janë shumë të rekomanduara.

Gjithashtu, trajneri mund të kërkojë nga ju që të përgatitni ndonjë detyrë specifike për seancat e diskutimit. Këto prezantime do ta motivojnë diskutimin në grup, që është një ndër mjetet më të forta të mësimin për këtë kurs.

Bibliografia:

- ECODES (2005) A Private Sector Strategy for Kosovo. The European Commission's Action Plan for Kosovo. Pristina
- ESOK (2004) Mainstreaming with Europe: an adult learning strategy for Kosovo (2005 – 2015) Pristina
- OECD Policy Index (2007) Report on the Implementation of European Charter on Small Enterprises in the Western Balkans. Brussels
- OECD Policy Index (2009) Report on the Implementation of European Charter on Small Enterprises in the Western Balkans. Brussels
- CBK (2009) Monthly statistics bulletin, Prishtinë: Central Bank of Republic of Kosova.
- World Bank (2005) Kosovo poverty assessment: promoting opportunity, security, and participation for all, Country Report No. 32378-XK
- PEM (2007) Technical Assistance for Further Modernisation of Kosovo's Vocational Education Training System, Phase III, SECTOR SKILLS NEEDS SURVEY IN KOSOVO, Prepared for European Agency for Reconstruction
- National Council on Economic Education (1991), Economics and Entrepreneurship Curricula, New York, NY (www.ncee.net)

Nga interneti:

- www.businessball.com (referencë e mëtejshme)
- www.Faithpopcorn.com (referencë e mëtejshme)
- www.bplans.com (referencë e mëtejshme)